



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr. 40, datë 28.09.2021

PËR DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI” I SKRAPARIT

Z. MUSTAFA DERVISHI (pas vdekjes)

Këshilli Bashkiak Skrapar, në mbledhjen e datës 28.09.2021, mori në shqyrtim propozimin të Kryetarit të Bashkisë, Z. Adriatik Mema, mbështetur në Ligjin Nr.139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, neni 9, “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1/7, gërma “a”, neni 54, “Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak”, gërma “m”, Ligjin Nr. 112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, neni 14, 15 pika 1, gërma “a”, pika 2, gërma “b”, neni 16 dhe vijues,

VENDOSI:

1. Dhënie e titullit “Qytetar Nderi” i Skraparit, Z. Mustafa Dervishi (pas vdekjes) me motivacionin:

“Për kontributin e tij të shquar profesional në zhvillimin e bujqësisë në Skrapar dhe më gjerë, aplikimin e metodave praktike bashkëkohore, si dhe në vlerësim të lartë të rezultateve të prekshme në punën e tij drejtuese, kërkimore dhe shkencore në këtë fushë. Qytetar model që dëshmoi kulturë dhe integritet të lartë në mbrojtje të vlerave më të mira njerëzore, duke kapërcyer me dinjitet vështirësitë e kohës që jetoi. Drejtues i spikatur që shërbeu me pasion, vizion dhe përkushtim në nivelin e qeverisjes vendore”.

2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Skrapar.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Vendimi u miratua me 13 vota pro, vota kundër – s’ka, vota abstenim – s’ka.

Për konfirmim Prefektit të Qarkut.



KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK

Edlira SHKËMBI

